



PLANI I BARAZISË GJINORE

2026-2028

BASHKIA PATOS

Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	2
Falënderime.....	3
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike	4
Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë	6
Demografia	7
Analfabetizmi.....	8
Niveli Arsimor	9
Statusi martesor.....	11
Statusi i nënës	13
Frekuentimi i çerdhes.....	15
Frekuentimi i Kopshtit	17
Persona me Aftesi te Kufizuar	18
Punësimi.....	20
Metodologjia.....	21
Vizioni dhe objektivat strategjike	23
Qëllimet dhe objektivat strategjike	24
Qëllimi Strategjik 1 (Q1):	24
Qëllimi Strategjik 2 (Q2):	25
Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	26
Qëllimi strategjik 1:	26
Objektivi Specifik (O1.1).....	26
Objektivi Specifik (O1.2).....	28
Objektivi Specifik (O1.3).....	29
Qëllimi strategjik 2:	30
Objektivi Specifik (O2.1).....	30
Objektivi Specifik (O2.2).....	33
Objektivi Specifik (O2.3).....	34
Objektivi Specifik (O2.4).....	35
Monitorimi dhe Raportimi	36

Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm. Për të avancuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi hartuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky dokument strategjik është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesve e specialistëve të bashkisë dhe njësive administrative, përfaqësuesve të komunitetit, institucioneve arsimore, shëndetësore, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve të Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë me mbështetjen teknike të Smart Processes.

Plani vendor për barazinë gjinore 2026 – 2028 bazohet në analizën e nevojave lokale dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, promovimin e barazisë gjinore midis grave dhe burrave, përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbime për gratë e burrat, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cënuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.

Bashkia mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojmë të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

Angazhimi ynë, drejt një Bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!

Falënderime

Bashkia Patos shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Patos, i cili ka mbështetur këtë proces nëpërmjet angazhimit të Komisionit për Barazinë Gjinore dhe Aleancës së Grave Këshilltare, duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.

Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në Bashki ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: Ky ligj i njeh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësisht.

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të marginalizuara në nivel lokal.

Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”, i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave lokale.

Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

Kodi i Punës, me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020, që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë. Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të marginalizuara.

Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, që përcakton mbështetje për gratë viktimat të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021, shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAË, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.).

Bashkia , nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale.

Plani është i harmonizuar me:

- Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- Planin e zhvillimit 20xx–20xx të Bashkisë Patos
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- Programin Kombëtar të Integritimit Evropian

Analiza e situatës gjinore ne territorin e bashkisë

Bashkia Patos ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë dhe është një nga bashkitë me zhvillim të rëndësishëm ekonomik në rajon, veçanërisht për shkak të industrisë së naftës dhe sektorit bujqësor. Zona karakterizohet nga një përzierje e komuniteteve urbane dhe rurale, ku qyteti i Patosit shërben si qendër administrative dhe ekonomike.

Bashkia Patos përfshin 3 njësi administrative:

Njesia Administrative	Tipologjia
Patos	rural
Zharëz	rural
Ruzhdie	rural

Burimi i të dhënave: INSTAT

Sipas të dhënave të fundit, bashkia ka një popullsi rreth 18,227 **banorë**, me një shpërndarje të popullsisë si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale.

Në aspektin social, bashkia është përballur me sfida që lidhen me migrimin e të rinjve, papunësinë, dhe nevojën për përmirësim të shërbimeve sociale, në veçanti për grupet më vulnerabël si gratë, të moshuarit, dhe personat me aftësi ndryshe.

Bashkia Patos është e angazhuar në përmirësimin e qeverisjes vendore dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke promovuar vlera si transparenca, barazia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, hartimi i **Planit të Barazisë Gjinore** përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Demografia

Tabela me poshte paraqet popullsin e bashkise sipas gjinise:

Popullsia	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Popullsia	9185	9042	18227	50.4	49.6


Burimi i të dhënave: INSTAT

Popullsia eshte e ndare neper njesi administrative si me poshte:

#	Njesia Administrative	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ruzhdie	957	954	1911	50.1	49.9
2	Patos	6144	6111	12255	50.1	49.9
3	Zharrez	2084	1977	4061	51.3	48.7

Burimi i të dhënave: INSTAT

Në grafik



Analfabetizmi

Tabela më poshtë paraqet numrin e personave mbi 10 vjeç që dinë shkrim e lexim.

Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Banore që nuk dine shkrime e kendim	152	231	383	39.7	60.3
Banore mbi 10 vjec	8257	8196	16453	50.2	49.8

Burimi i të dhënave: INSTAT

Nga gjithsej **16,453 banorë mbi 10 vjeç** në Bashkinë Patos, **383 persona nuk dinë shkrim e lexim**, që përbën rreth **2.3% të popullsisë** në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **231 janë gra dhe 152 janë burra**, që do të thotë se **60.3% e personave** që nuk dinë shkrim e lexim **janë gra, ndërsa 39.7% janë burra**.

Nëse krahasojmë këtë shpërndarje me përbërjen gjinore të popullsisë mbi 10 vjeç, ku përqindjet janë thuajse të barabarta (**50.2% meshkuj dhe 49.8% femra**), vërehet një disproporcion i qartë në dëm të grave. Edhe pse gratë përbëjnë pak më pak se gjysmën e popullsisë, ato përfaqësojnë një përqindje më të lartë mes personave analfabetë.

Kjo tregon se gratë janë më të ekspozuara ndaj analfabetizmit, veçanërisht në zona apo grupe ku mund të ketë kufizime në aksesin ndaj edukimit formal. Ky hendek përfaqëson një formë të përjashtimit gjinor nga arsimi bazë, me pasoja të drejtpërdrejta në mundësinë e grave për t'u përfshirë në aktivitetet ekonomike, sociale dhe politike.

Situata nënvizon nevojën për politika dhe programe të synuara për promovimin e edukimit bazë, veçanërisht për gratë që nuk kanë mësuar të lexojnë e shkruajnë, përmes programeve të edukimit për të rritur dhe fushatave sensibilizuese në komunitet.

Niveli Arsimor

Tabela me poshte paraqet nivelin arsimore te popullates.

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Asnjë nivel arsimor i përfunduar	40	59	99	40.4	59.6
2	Arsimi Fillor	354	614	968	36.6	63.4
3	Shkollë 7/8/9 vjeçare	3441	4126	7567	45.5	54.5
4	Shkollë e mesme	2790	2010	4800	58.1	41.9
5	Bachelor	253	299	552	45.8	54.2
6	Master ose Doktoraturë	209	278	487	42.9	57.1

Burimi i të dhënave: INSTAT

Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullsisë në Bashkinë Patos tregojnë një shpërndarje gjinore me disa tendenca të rëndësishme sociale dhe ekonomike, të cilat ndihmojnë në kuptimin e sfidave dhe mundësive për promovimin e barazisë gjinore në arsimin lokal.

Asnjë nivel arsimor i përfunduar – Në këtë kategori janë **99 persona, ku 59.6% janë gra dhe 40.4% burra**. Kjo tregon se gratë kanë qenë më të ekspozuara ndaj mungesës së arsimit bazë, gjë që mund të lidhet me faktorë historikë, socio-ekonomikë apo gjeografikë.

Arsimi fillor – Me gjithsej **968 persona, 63.4% janë gra dhe 36.6% burra**. Përqindja më e lartë e grave tregon se një pjesë e tyre ka ndërprerë shkollimin pas këtij niveli, një tregues që lidhet shpesh me detyrimet familjare apo kufizime ekonomike.


Shkollë 7/8/9-vjeçare – Kjo është kategoria më e përhapur, me **7,567 persona, ku 54.5% janë gra dhe 45.5% burra**. Shpërndarja relativisht e balancuar tregon përmirësim të aksesit të vajzave në arsimin e detyrueshëm.

Shkollë e mesme – Nga **4,800 persona** që kanë përfunduar arsimin e mesëm, **58.1% janë burra dhe 41.9% gra**. Kjo ulje e pjesëmarrjes së grave në këtë nivel tregon se vajzat përballen me pengesa për të vazhduar shkollimin pas shkollës së detyrueshme.

Bachelor – Në këtë nivel janë **552 persona, ku 54.2% janë gra dhe 45.8% burra**. Ky ndryshim tregon se gratë që kalojnë shkollën e mesme kanë më shumë mundësi të vazhdojnë studimet e larta.

Master ose Doktoraturë – Me **487** persona, gratë përbëjnë **57.1%** të këtij grupi, ndërsa burrat **42.9%**. Kjo tregon se në nivelet e avancuara akademike gratë janë në shumicë, duke reflektuar një prezencë të fortë në arsimin e lartë.

Përmbledhje – Të dhënat tregojnë dy tendenca kyçe: gratë përballen me më shumë përjashtim në nivelet e ulëta të arsimit, ndërsa në nivelet e larta janë në pozitë më të favorshme. Kjo pasqyron përmirësime te brezat e rinj, por edhe boshllëqe në shkollimin e mesëm dhe fillestar që duhet të adresohen me politika të synuara për mbajtjen dhe avancimin e vajzave në arsimin formal.




Burimi i të dhënave: INSTAT

Statusi martesor

Tabela me poshte paraqet popullsine mbi 10 vjec sipas statusit martesor

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	3276	2200	5476	59.8	40.2
2	I/e martuar	5499	5606	11105	49.5	50.5
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	116	110	226	51.3	48.7
4	I/e ve	294	1126	1420	20.7	79.3

Burimi i të dhënave: INSTAT



Shpërndarja sipas statusit martesor në Bashkinë Patos tregon dallime të dukshme gjinore, që reflektojnë norma sociale, jetëgjatësi dhe përjetime të ndryshme të burrave dhe grave në lidhje me martesën dhe familjen.

Në kategorinë “beqar(e)”, janë gjithsej **5,476 persona**, ku **59.8% janë burra dhe 40.2% gra**. Përqindja më e lartë e burrave mund të lidhet me tendencën që meshkujt të martohen më vonë ose të mbeten beqarë më gjatë se gratë.

Në kategorinë “i/e martuar”, numri total është **11,105 persona**, me një ndarje thuajse të barabartë: **49.5% burra dhe 50.5% gra**. Kjo tregon se martesa përfshin në mënyrë të përafërt të dy gjinitë, megjithëse mund të ketë ndryshime sipas moshës dhe faktorëve të tjerë socialë.

Në kategorinë “i/e divorcuar ose i/e ndarë”, janë 226 persona, ku 51.3% janë burra dhe 48.7% gra. Ndonëse përqindjet janë të afërta, pak më shumë burra janë në këtë status, që mund të lidhet me faktorë të ndryshëm individualë dhe socialë.


Në kategorinë “i/e ve”, janë 1,420 persona, ku 79.3% janë gra dhe vetëm 20.7% burra. Ky dallim i madh tregon se gratë jetojnë më gjatë se burrat dhe kanë më shumë mundësi të mbeten të veja, si dhe më pak prirje për rimartesë pas vdekjes së bashkëshortit.

Kjo shpërndarje tregon se gratë përballen më shpesh me vetminë dhe humbjen e partnerit, duke krijuar nevoja të veçanta për mbështetje sociale dhe ekonomike. Njohja e këtyre ndryshimeve është e rëndësishme për hartimin e politikave sociale që adresojnë nevojat specifike të grupeve sipas statusit martesor në nivel lokal.

Statusi i nënës

Tabela më poshtë tregon numrin e femrave që behen nëna sipas grupmoshës.

Grupmosha	Kane lindur	Nuk kane lindur	Gjithsej	% kane lindur	% NUK kane lindur
15-24 vjeç	91	689	780	11.7	88.3
25-34 vjeç	501	226	727	68.9	31.1
35-44 vjeç	700	128	828	84.5	15.5
45-54 vjeç	1064	164	1228	86.6	13.4
55-64 vjeç	1412	196	1608	87.8	12.2
65-74 vjeç	970	101	1071	90.6	9.4
mbi 75 vjeç	573	38	611	93.8	6.2



Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e grave mbi 25 vjeç në Bashkinë Patos janë bërë nëna, ndërsa përqindja e grave pa fëmijë është më e lartë tek grupmoshat më të reja.

Në grupmoshën 15–24 vjeç, vetëm 9.6% e grave kanë lindur fëmijë, ndërsa 90.4% nuk kanë lindur ende. Kjo tregon një tendencë moderne të shtyrjes së lindjeve, e cila mund të jetë e lidhur me vazhdimin e arsimit ose përqendrimin në karrierë.

Në grupmoshën 25–34 vjeç, 73.4% e grave janë bërë nëna, ndërsa 26.6% nuk kanë lindur. Kjo grupmoshë përfaqëson periudhën më aktive të lindjeve dhe jetës riprodhuese.

Në grupmoshën 35–44 vjeç, 90.5% e grave kanë lindur, që tregon se shumica tashmë kanë përmbushur rolin e tyre riprodhues.

Në grupmoshat 45–54, 55–64, 65–74 dhe mbi 75 vjeç, përqindja e grave që kanë lindur fëmijë varion nga 93.1% në 97%, duke reflektuar normat e brezave të mëparshëm ku të pasurit fëmijë ishte norma sociale.

Kjo shpërndarje evidenton ndryshime të dukshme midis brezave, ku gratë më të reja kanë më shumë mundësi të mos jenë bërë ende nëna, ndërsa gratë më të mëdha zakonisht kanë lindur fëmijë.


Kuptimi i këtyre ndryshimeve është i rëndësishëm për përcaktimin e politikave sociale dhe shërbimeve që adresojnë nevojat e grave në faza të ndryshme të jetës, si mbështetja në planifikimin familjar për të rinjat, dhe kujdesi apo përfitimet sociale për gratë në moshë më të madhe.

Frekuentimi i çerdhes

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek Çerdhen	59	62	121	48.8	51.2
2	NUK ndjek çerdhen	162	138	300	54	46

Burimi i të dhënave: INSTAT



Nga gjithsej **421 fëmijë të moshës 0–3 vjeç** në Bashkinë Patos, **121 fëmijë (rreth 28.7%) ndjekin çerdhen**, ndërsa **300 fëmijë (rreth 71.3%) nuk ndjekin**.

Në grupin e **fëmijëve që ndjekin çerdhen, 51.2% janë vajza dhe 48.8% djem**. Kjo shpërndarje tregon një akses relativisht të barabartë gjinor në shërbimin e çerdhes, pa dallime të mëdha midis gjinive.

Në grupin e **fëmijëve që nuk ndjekin çerdhen, 54% janë djem dhe 46% vajza**, çka konfirmon se nuk ka diferenca të theksuara gjinore në mungesën e përfshirjes në këtë shërbim.

Përqindja relativisht e ulët e fëmijëve që ndjekin çerdhen mund të lidhet me faktorë si mungesa e kapaciteteve, kufizimet ekonomike të familjeve, ose praktikat kulturore që favorizojnë kujdesin në shtëpi, shpesh të kryer nga nënat.

Kjo situatë ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë gjinore, pasi mungesa e shërbimeve të kujdesit për fëmijët kufizon mundësitë e grave për të qenë pjesëmarrëse aktive në tregun e punës dhe në jetën sociale.

Prandaj, këto të dhëna tregojnë nevojën për zgjerim të kapaciteteve dhe përmirësim të aksesit në shërbimet e çerdheve, si një masë kyçe për të mbështetur barazinë gjinore dhe për të ndihmuar gratë në balancimin e rolit familjar dhe profesional.

Frekuentimi i Kopshtit

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve të moshës 3-6 vjec që ndjekin kopshtin

#	Frekuentimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek kopshtin	178	129	307	58.0	42.0
2	NUK ndjek kopshtin	124	78	202	61.4	38.6

Këtu vihet re se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve **nuk ndjekin kopshtin (202 gjithsej)**, dhe ndër ta **djemtë përbëjnë një përqindje pak më të lartë (61.4%) krahasuar me përfaqësimin e tyre në kopshte (58%)**. Kjo do të thotë se djemtë janë pak më të prirur të mbeten jashtë institucioneve parashkollore krahasuar me vajzat, çka është një fenomen që meriton vëmendje.

Ky fakt ka ndikim të drejtpërdrejtë te prindërit, sidomos nënat, sepse në kontekstin tonë shoqëror, kujdesi për fëmijët e moshës parashkollore bie kryesisht mbi to. Prandaj:

– Prindërit e fëmijëve që nuk ndjekin kopshtin kanë më pak mundësi të jenë të angazhuar në punësim me kohë të plotë apo të ndjekin karrierën.

– Kjo situatë mund të ndikojë ndryshe tek familjet me djem, duke krijuar hendek në mundësitë e barabarta për fëmijët në edukimin e hershëm.

Në këtë mënyrë, të dhënat e Bashkisë Patos tregojnë një prirje që mund të kontribuojë në një pabarazi të hershme gjinore në aksesin në arsim parashkollor: djemtë mbeten më shpesh jashtë kopshteve → prindërit (sidomos nënat) mbajnë barrën e kujdesit → kufizime në angazhimin profesional të prindërve.


Kjo tendencë duhet të jetë një pikë kyçe në planin për barazinë gjinore të Bashkisë Patos, me ndërhyrje konkrete për të:

- rritur numrin e fëmijëve, veçanërisht djemve, që ndjekin kopshte publike,
- zgjeruar kapacitetet e institucioneve parashkollore,
- ofruar lehtësira për prindërit që punojnë, dhe
- promovuar ndarjen e barabartë të përgjegjësisë të kujdesit brenda familjes.

Persona me Aftësi të Kufizuar

Tabelat më poshtë tregojnë numrin e personave me aftësi të kufizuara në bashki, në total dhe të ndarë sipas llojit të vështirësisë.

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
5-14 vjec	12	2	14	85.7	14.3
15-64 vjec	250	263	513	48.7	51.3
mbi 65 vjec	321	427	748	42.9	57.1



Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Patos tregojnë një prirje të qartë gjinore, me ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë dhe përfshirjen sociale të grave.

Në grupmoshën 5–14 vjeç, shpërndarja mes djemve dhe vajzave është e pabarabartë në favor të djemve, ku **85.7% e personave me aftësi të kufizuara janë meshkuj dhe vetëm 14.3% femra**. Por me rritjen e moshës, përqindja e grave me aftësi të kufizuara rritet ndjeshëm.

Në grupmoshën 15–64 vjeç, gratë përbëjnë 51.3% të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, ndërsa në moshën mbi **65 vjeç kjo përqindje arrin në 57.1%**. Kjo tendencë reflekton faktorë si jetëgjatësia më e madhe e grave, mungesa e aksesit të barabartë në kujdes shëndetësor gjatë jetës, si dhe ndikimin e barrierave shoqërore dhe ekonomike që i bëjnë gratë më të ekspozuara ndaj problemeve shëndetësore dhe vështirësive funksionale.


Këto dallime gjinore konfirmohen edhe kur analizohen sipas llojit të vështirësisë. Në çdo kategori të shqyrtuar – përveç dëgjimit dhe komunikimit, ku ndarja është pothuajse e barabartë – gratë

përfaqësojnë përqindjen më të lartë. Më e theksuara është në vështirësinë për ecje, ku 59.3% e personave të prekur janë gra. Ato janë gjithashtu më të shumta në vështirësitë në shikim (58%), kujtesë (51.2%), kujdesin e përditshëm ndaj vetes (52.1%) dhe komunikim (51.1%). Kjo tregon se gratë me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të shumëfishta fizike, ekonomike, institucionale dhe kulturore. Në shumë raste, ato përjetojnë një formë të dyfishtë diskriminimi – si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara – që i kufizon në aksesin në arsim, punësim, shërbime dhe jetë të pavarur.

Këto të dhëna tregojnë qartë nevojën për politika sociale dhe plane për barazinë gjinore që adresojnë në mënyrë specifike sfidat e grave me aftësi të kufizuara. Bashkia Patos duhet të marrë masa për të siguruar infrastrukturë të aksesueshme, mbështetje për kujdesin personal dhe shëndetësor, përfshirje në tregun e punës dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna. Përfshirja e kësaj kategorie në planifikimin gjinor është thelbësore për të garantuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

#	Lloji i vështirësisë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Në shikim	202	279	481	42.0	58.0
2	Në dëgjim	175	181	356	49.2	50.8
3	Në ecje	330	480	810	40.7	59.3
4	Kujtesë	177	186	363	48.8	51.2
5	Kujdesin e përditshëm ndaj vetes	204	222	426	47.9	52.1
6	Në komunikim	152	159	311	48.9	51.1

Burimi i të dhënave: INSTAT



Punësimi

Plotësoni:

Numri i të punësuarve sipas gjinisë:

- Femra: ...
- Meshkuj: ...

Numri i të papunëve sipas gjinisë:

- Femra: ...
- Meshkuj: ...

Numri i të vetëpunësuarve sipas gjinisë:

- Femra: ...
- Meshkuj: ...

Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikatat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e bashkisë, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmoshave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuar, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të bashkisë, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u shqyrtua nëse bashkia kishte miratuar Kartën për Barazinë Gjinore, nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u

vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologj ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e bashkisë, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë 2026–2028 ndërtohet mbi **qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyer në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

Qëllimi Strategjik 1 (Q1):

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet Bashkia. Në këtë kuadër, barazia gjinore nuk konceptohet si një qëllim i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendor, përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, në promovimin e barazisë gjinore si një element i padiskutueshëm i qeverisjes së mirë.

Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifike:

- **1.1.** Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale.
- **1.2.** Fuqizimi i mekanizmave institucionalë lokalë që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale.
- **1.3.** Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

Qëllimi Strategjik 2 (Q2):

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cenueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifikë:

- 2.1.** Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.
- 2.2.** Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- 2.3.** Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.
- 2.4.** Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbytjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.



Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi strategjik 1:

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Objektivi Specifik (O1.1) Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë dhe të KBRE-së.	2026	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare web të bashkisë; IT I/e bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare	5,000 lekë (faqe web, staf teknik)	Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhëzimeve dhe tabelave të treguesve për monitorim.	2026	Njësia e Planifikimit Strategjik dhe Njësia e performancës	Njësia përgjegjëse për hartimin e statistikave/performancës	90,000 lekë(dizajnim + printim udhëzues)	Dokument i përfunduar dhe shpërndarë në drejtoritë përkatëse
1.1.3 Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të	2026 - 2028	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë	180,000 lekë (trajnerë + logjistikë)	Numri i punonjësve të trajnuar dhe

dhënave me tregues gjinorë.					vlerësimi pas-trajnimit
1.1.4 Krijimi i një platforme online të hapur për publikimin e statistikave dhe konsultime publike për masat për barazinë gjinore në Bashki	2026 - 2027	IT I/e bashkisë	AKSHI, Shoqëria Civile	450,000 lekë (zhvillim platforme, miëmbajtje 1 vit)	Platforma funksionale dhe numri i përdoruesve aktivë
1.4.5 Përfshirja në rubrikën përkatëse të seksionit për konsultime publike për buxhetimin dhe nxitjen e pjesëmarrjen gjinore	2026	Njësia përgjegjëse për hartimin e Buxhetit Afatmesëm	Njësitë Administrative, Gra Këshilltare	60,000 lekë (takime + publikime informative)	Seksioni funksional dhe pjesë`marrje gjinore në konsultime
1.4.6 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave dhe DHF	Viti 2026 (i përsëritshëm çdo vit)	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, media	120,000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit
1.4.7 Sistem i integruar dixhital për mbledhjen dhe analizën gjinore të të dhënave në nivel lokal	2027 – 2028	IT dhe Përgjegjësit/drejtuesit e drejtorive/sectorëve në bashki	INSTAT, partnerë teknikë, ekspertë të fushës	700,000 lekë (zhvillim sistemi + trajnime)	Sistem funksional, numri i të dhënave të përpunuara gjinor

Objektivi Specifik (O1.2) Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie	2026	Kryetari i Bashkisë	Drejtuesit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	80,000 lekë (mbledhje, dokumente, koordinim, orë pune)	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike të dokumentuara
1.2.2 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Ekspertë të kontraktuar	100,000 lekë (trajnerë, logjistikë, materiale)	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve
1.2.3 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi barazinë gjinore dhe anti-diskriminimin sipas një kalendarit vjetor të miratuar.	2026 - 2028	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Shkolla e Administratës Publike, OJF	300,000 lekë/vit (paketa trajnuese, fasilitatorë, certifikime)	Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor
1.2.4 Draftimi dhe miratimi një politike lokale kundër ngacmimit seksual dhe diskriminimit (PSEA)	2026 - 2028	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe koordinatori BGJ & Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria Juridike, OJF		Dokumenti i plotikave i miratuar

Objektivi Specifik (O1.3) Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal.

Aktivitet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
1.3.1 Takime informuese me administratorët shoqërorë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa.	2026	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë (koordinatori i barazisë gjinore) & Njësitë Administrative	75,000 lekë (organizim, materiale, orë pune)	Numri i takimeve dhe pjesëmarrësve përfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolet gjinore në komunitete rurale dhe lagje urbane	2026 - 2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë (koordinatori i BGJ) & Njësitë Administrative	OJF lokale, shkolla, grupet e interesit	150,000 lekë (postera, aktivitete, facilitim, orë pune)	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.3 Organizimi i fushatave të komunikimit gjinor me media lokale dhe shkolla.	2026 - 2028	Drejtoria e Komunikimit & Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Media lokale, ZVA, Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, OJF	180,000 lekë (video, përmbajtje edukative, publikime)	Numri i fushatave të zhvilluara në media dhe shkolla
1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe të rregullta me organizatat e grave dhe grupet në nevojë për probleme dhe sfida në ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike lokale;	2026 e në vijim	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & Zyra për Marrëdhënie me Komunitetin	OJF, grupime komunitare, përfaqësues të shërbimeve	120,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune)	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara në shërbimet publike

Qëllimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Objektivi Specifik (O2.1) Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.

Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të NJVRR (Njësitë Vendore të Referimit dhe Reagimit) për çdo njësi administrative	2026	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Njësitë Administrative, Njësia përgjegjëse për barazinë gjinore në bashki (Koordinatori i barazisë gjinore) Policia, Shërbimi Shëndetësor	350,000 lekë (formim strukturash, trajnime, logjistikë, orë pune)	Numri i strukturave NJVRR të ngritura dhe funksionale në njësi administrative
2.1.2 Shërbime të reja të arsimit parashkollor (cerdhe e kopshte) në mbështetje të grave për të rritur punësimin e tyre.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë & ZVA	Njësitë Administrative, Donatorë		Shërbime të reja të ofruara
2.1.3 Ndërgjegjësim i të rinjve mbi prindërimin e balancuar gjinor.	2027-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit Rinisë	Donatorë		Numri i fushatave të ndërgjegjësimit

2.1.4 Krijimi i një programi vjetor të granteve të vogla për nxitjen e nismave sociale dhe bizneseve të vogla të grave (me vëmendje për zonat rurale)	2026-2028	Njësia përgjegjëse për Zhvillimin Ekonomik dhe Bujqësisë	Agjencia e Zhvillimit Rajonal, Donatorë, OJF ekonomike	1,200,000 lekë/3 vite (fond për grante, promocion, ndihmë teknike, lehtësi fiskale)	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale
2.1.5 Shtimi i një programi të dedikuar trajnimit për vajza dhe djem të rinj, me fokus në zhvillimin e aftësive për ofrimin e shërbimeve në sektorin e turizmit, si një mundësi për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të komunitetit.	2027	Dhoma e Tregëtisë & Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Donatorë		Numri i programeve të reja të trajnimeve
2.1.6 Krijimi i qendrave komunitare për Gratë dhe Vajzat në çdo njësi administrative	2026-2027	Njësitë përgjegjëse për Infrastrukturën, shërbimet publike, & ndjekjen e investimeve në bashki	Njësitë Administrative, Arkitektë, Shoqata komunitare	700,000 lekë (mobilitet, ambiente, mirëmbajtje fillestare)	Numri i qendrave komunitare të hapura dhe frekuentimi i tyre
2.1.7 Krijimi dhe funksionalizimi i një njësie lëvizëse për ofrimin e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale në banesë, me fokus të veçantë tek	2027-2028	Njësitë përgjegjëse për Infrastrukturën, shërbimet publike, & ndjekjen e investimeve në bashki	Njësitë Administrative, Arkitektë, Shoqata komunitare		Numri i njësisve të reja lëvizëse

gratë e vetmuara (të veja dhe të moshuara) dhe personat me aftësi të kufizuara, me qëllim përmirësimin e aksesit në shërbime bazë dhe rritjen e përfshirjes sociale të këtyre grupeve vulnerabël.					
2.1.8 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2026-2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	ZVA , OJF edukative, mësues të përzgjedhur	180,000 lekë (modulim materialesh, trajnim i mësuesve, monitorim)	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse
2.1.9 Ofrimi e këshillimit të karrierës për vajzat e djemtë dhe ndërgjegjësim për rolet dhe profesionet gjinore.	2026-2028	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	OJF		Numri i sesioneve të këshillimit

Objektivi Specifik (O2.2) Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.

Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokolli të ndjeshëm gjinor për reagim në raste pandemie, fatkeqësi natyrore ose kriza civile	2027	Njësia përgjegjëse për shërbimet e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shëndetësisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	200,000 lekë (ekspertizë ligjore dhe sociale, konsultime)	Dokument protokolli i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore
2.2.2 Forcimi i MKR dhe rritja e efciences. <i>Do ta specifikojmë këtë aktivitet në bazë të situatës specifike të organigramës së drejtorisë dhe stafit.</i>	2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, OJF		
2.2.3 Konsulencë ligjore falas për çështjet e diskriminimit gjinor;	2026–2027	Drejtoria e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Qendra Ligjore e Ndihmës Falas, OJF për të drejtat e grave	250,000 lekë/vit (pagesa për ekspertë, zyra këshillimi, informim publik)	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara

Objektivi Specifik (O2.3) Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.3.1 Zbatimi i nismes ‘Qytete të sigurta për grate, vajzat dhe grupet në nevojë’ në 3 lagje pilot përmes ndriçimit, sinjalistikës dhe shenjimit të hapësirave publike të sigurta.	2026 - 2028	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	Policia Bashkiake, OJF për të drejtat e grave	1,000,000 lekë (projekt teknik, ndriçim, sinjalistikë, promovim, orë pune)	Numri i lagjeve të përfshira dhe ndërhyrjet infrastrukturore të realizuara

Objektivi Specifik (O2.4) Të sigurohet përfshirja e barabartë gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, përmes aksesit të drejtë në infrastrukturë, përmbajtje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.

Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.4.1 Pasurimi i fondit të bibliotekës me libra që theksojnë rolin pozitiv të grave dhe burrave në fusha të ndryshme, si dhe promovimi i leximit të barabartë gjinor përmes klubeve të leximit	2026 - 2028	Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Biblioteka e qytetit, ZVA, OJF kulturore	120,000 lekë (blerje librash, promovim, aktivitete, orë pune)	Numri i librave të blerë; numri i aktiviteteve të leximit
2.4.2 Promovimi i klubeve të leximit për barazi gjinore	2026 - 2028	Biblioteka & Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë	Shkolla, OJF, klube rinore	80,000 lekë (materiale, lexim i drejtuar, takime diskutimi, orë pune)	Numri i klubeve funksionale, qendrat rinore dhe pjesëmarrësve (sipas gjinisë)
2.4.3 Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në veprimtari kulturore e sportive përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe programeve të përshtatura të ndjeshme ndaj gjinisë	2026 -2028	Drejtorja e Cështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë Drejtorja e Kulturës, dhe Sportit	Klube sportive, Njësitë Administrative, komuniteti	900,000 lekë (rindërtime të vogla, programe, trajnime)	% e grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitete; numri i ambienteve të përshtatura

- ## Monitorimi dhe Raportimi

- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

6.5 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave gjinore dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

6.Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.